



**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°14/2021

Hagë, 16/12/2021

**Përditësim**

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë si dhe informacion për javën e ardhshme. Gjithashtu, kjo është një mundësi që gazetarët t'i drejtojnë pyetje që mund të kenë zëdhënësit të Gjykatës.

Këtë javë në Dhomat e Specializuara të Kosovës u mbajtën seanca për tri çështje gjyqësore.

Në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, në fillim të javës Trupi Gjykses dëgjoji dëshmitarin e thirrur nga Prokurori i Specializuar, i cili dëshmoi me masa mbrojtëse, ku përfshihet ndryshimi i zërit, fytyrës dhe përdorimi i një pseudonimi. Dëshmitari pothuajse gjithë dëshminë e dha në seancë private, për shkak të natyrës identifikuese të dëshmisë. Ky dëshmitar dha shkurtimisht dëshmi në seancë të hapur lidhur me zhvarrosjen e një kufome në Zllash.

Seancat gjyqësore për këtë çështje do të rifillojnë më 18 janar me dëshminë e dëshmitarit W04485, të thirrur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

Në çështjen gjyqësore *Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj*, javën e kaluar paraqiti provat e veta Mbrojtja e Hysni Gucatit. Dëshmitari i parë që u thirr ishte vetë i akuzuari, i cili dëshmoi për tri ditë. Trupi Gjykses dëgjoji dëshmitë e pesë dëshmitarëve të tjerë që janë anëtarë të Organizatës të Veteranëve të Luftës së UÇK-së dhe gazetarë.

Këtë javë për këtë çështje gjyqësore u mbajt vetëm një seancë ditën e mërkurën, më 15 dhjetor.

Trupi Gjykses autorizoi Mbrojtjen e Gucatit t'u drejtonte pyetje shtesë dy dëshmitarëve të thirrur nga Prokuroria në muajt tetor dhe nëntor. Pyetjet e Mbrojtjes lidheshin vetëm me materialin që iu dha Mbrojtjes pas mbylljes së paraqitjes së

1





**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°14/2021

Hagë, 16/12/2021

provave nga Prokuroria. Pyetjet nga Mbrojtja u bënë në seancë private për të mbrojtur identitetin e dëshmitarëve dhe sigurinë e informacionit.

Në të njëjtën seancë, Mbrojtja e Haradinajt hapi çështjen e vet si dhe bëri deklaratën hyrëse. Mbrojtja e Haradinajt do të fillojë me paraqitjen e provave më 11 janar 2022, pasi avokatët e z. Haradinaj kërkuan shtyrje për shkak të sëmundjes së mbrojtësit.

Trupi Gjykses theksoi se kjo sëmundje nuk është arsye, në vetvete, për të shtyrë procesin gjyqësor. Megjithatë Trupi Gjykses mori parasysh vështirësitë e bashkëmbrojtësit për të komunikuar me të akuzuarin, në mungesë të mbrojtësit, dhe e shtyu nisjen e paraqitjes së provave në çështjen *Haradinaj* për në 11 janar, kur pritet të dëshmojë z. Haradinaj.

Gjithashtu, ditën e mërkurë u mbajt konferenca e nëntë për ecurinë e çështjes gjyqësore në çështjen *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi*. Temat për diskutim përfshinin një mori pikash lidhur me nxjerrjen e provave prej Prokurorisë për Mbrojtjen, përkthimin e listës paraprake të dëshmitarëve, ecurinë e hetimeve dhe parashtrimin e protokolluar të dosjes paraprake të Prokurorit të Specializuar.

Më 10 dhjetor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin e dytë për pjesëmarrjen e viktimave në këtë çështje, ku pranoi 11 viktima të tjera për të marrë pjesë në proces dhe vendosi për masat mbrojtëse lidhur me këto viktima pjesëmarrëse. Viktimat në fjalë do të përfshihen në Grupin 1 ekzistues të viktimave pjesëmarrëse dhe do të përfaqësohen nga i njëjti mbrojtës i viktimave.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake dje nxori një vendim ku pranoi një viktimë për pjesëmarrje në procesin gjyqësor. Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej udhëzoi Administratoren të caktojë mbrojtësin e viktimave brenda 28 janarit 2022.





**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°14/2021

Hagë, 16/12/2021

Është e rëndësishme të theksohet se në të gjitha çështjet gjyqësore në Dhomat e Specializuara të Kosovës, mbetet i hapur procesi i parashtrimit të kërkesave të viktimave për pjesëmarrje në proceset gjyqësore.

Të hënën e ardhshme Dhomat e Specializuara të Kosovës fillojnë pushimin dimëror që zgjat tri javë. Gjatë pushimit dimëror nuk mbahen seanca gjyqësore përveçse në rrethana të veçanta. Sidoqoftë, Gjykata gjatë kësaj periudhe do të jetë plotësisht funksionale në aspektet e tjera dhe puna do të vijojë normalisht në të gjitha njësitë e DHS-së.

Seanca e ardhshme publike për vitin e ardhshëm është planifikuar të mbahet më 11 janar në çështjen gjyqësore *Gucati dhe Haradinaj* dhe informimi i ardhshëm javor do të bëhet më 13 janar.

**Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje

